

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën zgjedhore mësimore **Ekonomia për vitin e IV (e katërt) të arsimit të mesëm - gjimnaz** për vitin shkollor 2020/2021.

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës **Ekonomia**, për vitin e IV (**katërt**), të arsimit të mesëm – gjimnaz për vitin shkollor 2020/21, bazohet në qëllimet/rezultatet e parashikuara në programin mësimor për lëndën që rregullisht realizohet sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 3 orë, në programin e shkurtuar parashikohen 87 orë mësimore.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet/rezultatet e parashikuara, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

Tema 1: Hyrje në ekonomi (6 orë)

Njësitë mësimore:

- Ekonomia si shkencë: definicioni, konceptet, metodologjia
- Parimet themelore të të menduarit ekonomik

Tema 2: Elementet themelore të kërkesës dhe ofertës (6 orë)

Njësitë mësimore:

- Kërkesa dhe faktorët që kushtëzojnë atë
- Lakorja (kurba) e kërkesës
- Oferta dhe faktorët që e kushtëzojnë atë

- Lakorja (kurba) e ofertës

Tema 3: Bazat e teorisë së prodhimit (6 orë)

Njësitë mësimore:

- Organizimi i prodhimit – format e biznes organizatave
- Funksioni prodhues
- Faktorët e prodhimit

Tema 4: Analiza e kostos (6 orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni dhe kuptimi i kostos
- Llojet e kostove
- Relacino midis të ardhurave, fitimit dhe kostos

Tema 5: Struktura e tregut (4 orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni dhe llojet e strukturave të tregut
- Konkurenca e përsosur dhe konkurenca jo e plotë
- Monopoli dhe pengesat për hyrje

Tema 6: Faktorët e prodhimit dhe vlera e tyre në treg (6 orë)

Njësitë mësimore:

- Çmimi dhe të ardhurat e faktorëve të prodhimit
- Kërkesa për faktorët e prodhimit
- Produktiviteti marginal i faktorëve të prodhimit
- Lidhja midis të ardhurave dhe sipërmarrjes

Tema 7: Huatë dhe tregu i punës (4 orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni dhe llojet e huasë
- Tregu i punës
- Oferta dhe kërkesa në tregun e punës

Tema 8: Rregullimi dhe derregullimi i sektorëve ekonomik (4 orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni dhe kuptimi i rregullacionit shtetëror
- Privatizimi (derregullimi)

Tema 9: Nocionet themelore makroekonomike (8 orë)

Njësitë mësimore:

- Makroekonomia
- Politikat themelore makroekonomike
- Kërkesa agregate dhe oferta agregate
- Bilanci makroekonomik

Tema 10: Produkti dhe të ardhurat nacionale (9 orë)

Njësitë mësimore:

- Definimi i bruto prodhimit nacional
- Llogaritja e bruto prodhimit nacional
- Bruto prodhimi nacional normal, real, faktik dhe potencial

Tema 11: Papunësia dhe inflacioni (10 orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni, llojet dhe shkaqet e papunësisë
- Nocioni, thelbi dhe matja e inflacionit
- Relacioni midis inflacionit dhe papunësisë – Kurba e Phillips në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë

Tema 12: Shteti dhe ekonomia (9 orë)

Njësitë mësimore:

- Teoritë ekonomike për rolin e shtetit
- Politika fiskale (të ardhurat publike, shpenzimet publike dhe buxheti)
- Politika monetare

Tema 13: Ekonomia ndërkombëtare (9 orë)

Njësitë mësimore:

- Nocioni, karakteristikat themelore dhe format e ekonomisë ndërkombëtare
- Proteksionizmi dhe tregtia e lirë
- Kursi i këmbimit

3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Njësitë mësimore në programin e shkurtuar mësimor nga lënda zgjedhore **Ekonomi**, për vitin e IV (**katërt**) na arsimit të mesëm - gjimnaz për vitin shkollor 2020/21, e japin rrjedhën e realizimit të materialit mësimor. Sipas nevojave, mësuesit vetë e shpërndajnë fondin e parashikuar të reduktuar të orëve të destinuara për përmbajtjet e reja, për përsëritje, definim, ushtrime, kontrollim i njohurive të nxënësve, sistematizim, hulumtim, realizim të projekteve, organizim i ngjarjeve etj.

Mësuesi individualisht e integron monitorimin e arritjeve të nxënësve në kuadër të orëve të parashikuara për realizim, duke përdorur metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme. Informata kthyese konstruktive dhe në kohë u mundëson nxënësve të identifikojnë hapat e ardhshëm të nevojshëm për të avancuar mësimin e tyre.

Për të arritur qëllimet e programit të rregullt mësimor në lëndën Ekonomia, është planifikuar të zbatohen mjete të ndryshme mësimore dhe ndihmëse: libra shkollor dhe doracakë të aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe burime të tjera mësimore, pajisje kompjuterike dhe multimedia, projektor LCD, mjete mësimore audio-vizuele, internet, software arsimor, përmbajtje digjitale, platforma arsimore, aplikacione etj., sipas kushteve dhe mundësive të shkollës.

4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën zgjedhore **Ekonomia** për vitin IV (e katërt) të arsimit të mesëm- gjimnaz, e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska